

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Universiteti Politeknik i Tiranës, si një institucion i arsimit të lartë, vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale.

Detyrat dhe funksionet e Universitetit Politeknik të Tiranës janë:

1. Sigurimi i arsimit cilësor në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. Sigurimi i kushteve dhe infrastrukturës së nevojshme për studim dhe kërkim shkencor;
3. Të sigurojë dhënien e gradave shkencore, titujve akademik dhe kualifikime të tjera shkencore;
4. UPT promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit të shoqërisë, përmes transferimit të teknologjisë dhe informacionit, si edhe shërbimeve për territorin dhe komunitetin.
5. UPT promovon kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar; ai siguron koordinimin dhe zhvillimin e projekteve kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. UPT nxit përfitim të njohurive më të përparuara shkencore dhe teknologjike dhe u jep vlerë ekspertizës dhe aftësive kërkimore të tij në fusha të ndryshme të shkencës dhe kërkimit.
6. UPT ofron të gjitha nivelet e arsimit të lartë, që u korrespondojnë niveleve 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. UPT përcakton, zhvillon dhe konsolidon mënyrat e kontrollit të dijeve të studentëve sipas parimeve të meritës dhe paanshmërisë.
7. UPT mbështet dhe mbron studentët në ushtrimin e të drejtës së tyre për arsim cilësor dhe siguron përfaqësimin e tyre si partnerë të plotë në qeverisjen e tij. UPT promovon inovacionin në mësimdhënie në një mjedis ku qendra është studenti, duke shfrytëzuar gjerësisht potencialin e teknologjive të reja në mësimdhënie.
8. UPT ofron këshillim dhe monitoron zhvillimin e karrierës akademike të studentëve.
9. UPT garanton zhvillimin e karrierës së personelit akademik, në respekt të lirisë akademike, meritës dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
10. UPT mundëson kualifikimin e vazhdueshëm të personelit ndihmës-akademik dhe administrativ.